

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen Albulena Topallii-praktikante në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1040-5/16 me datë 27.04.2017 për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë PP/II.nr.1040-5/16 me datë 27.04.2017 për dhënien e urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me datë. 08.11.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1040-5/16 me datë 27.04.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim në [REDACTED] komuna [REDACTED], i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], i papunë, i gjendje së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 26.05.2016, rreth orës 14.19, në pyllin public, në vendin e quajtur 'Te Kroni i Hasan Mases' në Rajonin Ekonomik Pyjor Nerodim Jezerc, është takuar duk prer 7copa trungje të ahut të njoma, me diametër prej 20-35 cm e të gjata boniteti III, e me vëllim të përgjithshëm prej 2.45 metra kub e në vlerë prej 363.15 euro, drunjte kanë qen të prerë me sharrë motorrike dhe të transportuara me traktor Rakovicë..

- me këtë ka kryer veprën penale, vjedhje pylli nga neni 358. par 1 të KPRK së,

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4,7,21,41,42,43,46,73, të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari, që Drejtorise për Bujqësi , Pyltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj të ia kompenzojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 363.15 €(treqind e gjashtëdhjetë e tri euro e pesëmbëdhjetë cent), nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë .

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1040-5/16 me datë 27.04.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për vepër penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si, fletparaqitja e rojës së pyellit me vlersimin dhe llogaritja e dëmit të pyllit nr.246/2016 i datës 20.06.2016 i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, si dhe të bëhet shiqimi i fotografive në shkresatë e lëndës.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P. nr. 2627/17 me datë 08.11.2017

Praktikante

Albulena Topalli

Gjyqtari

Hakile Ilazi



KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.